

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË "NAUL" Sh.p.k.**

Sot, me datë 20/10/2020,

**Z. Luan Mumajesi**, shtetas shqiptar, atësia Xhemal, lindur më 10/03/1964, në Tiranë, banues në adresën: Rruga "Ali Demi", Pall. 70, Hyrja 4, Ap. 31, Tiranë, mbajtës i dokumentit Pashaportë me Nr. BC2496297 dhe nr. personal. G40310467H, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "NAUL" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1. EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "NAUL" Sh.p.k.

**NENI 2. SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Ali Demi", Pall. 70, Hyrja 4, Ap. 31, Tiranë.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3. KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4. OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Investime të ndryshme;
- Studime tregu;
- Menaxhim dhe zhvillim projektësh;
- Shitblerje dhe/ose qera të pasurive të paluajtshme, ndërmjetësim shitblerje dhe / ose qera;

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.





## NENI 5. KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 1.000.000 (një milion) Lekë dhe përbëhet nga një 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Luan Mumajesi**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë dhe 1.000.000 (një milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6. ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Luan Mumajesi**, shtetas shqiptar, lindur më 10/03/1964, në Tiranë, mbajtës i dokumentit Pashaportë me Nr. BC2496297 dhe nr. personal. G40310467H, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cill zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8. DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Luan Mumajesi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**LUAN MUMAJESI**